

NL 1387
D704/04/2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1142 prot.

Tiranë, më 03.04. 2019

URDHËR

Nr. 496, datë 03.04 2019

**PËR
KONTROLLIN E KUSHTEVE TË PRODHIMIT NË AMBIENTET E SUBJEKTEVE
TË LICENSUARA PËR PRODHIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM
CIVIL PRODHIMIN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKE DHE FISHEKZJARRE PËR
PËRDORIM CIVIL DHE PRODHIMIN ÇAKTIVIZIMIN DHE RIPARIMIN E
ARMËVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ndryshuar; të germës “f” të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 113, i ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; pika 1 e nenit 7 dhe pika 2 e nenit 7/1 të ligjit 9126 datë 29.07.2003 “Për përdorimin Civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 13 të ligjit 74/2014 “Për Armët”, VKM nr. 932, datë 18.11.2015 “Për procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil”, VKM nr. 469, datë 29.6.2011 “Për procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”, i ndryshuar, VKM Nr. 658, datë 29.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve”,

URDHËROJ

1. Komisioni i Dhënies së Lejeve dhe Licensave pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) të kryejë kontrollin e kushteve të prodhimit në ambientet e subjekteve të licencuara për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, prodhimin e artikujve piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil dhe prodhimin çaktivizimin dhe riparimin e armëve nëpërmjet specialistëve të vënë në dispozicion për këtë qëllim nga Shtabi i Përgjithshëm i FA.
2. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, në përgjigje të kërkesës së AKSHE, të vë në dispozicion të saj, me qëllim kryerjen e kontrollit specialistë të fushës;
 - Një specialist kimist
 - Një specialist për prodhimin të lëndëve plasëse dhe/ose lëndëve piroteknike
 - Një specialist armatim municioni.
 - Një specialist për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi.

3. Inspektimi të kryhet çdo 6 muaj në ambientet e prodhimit të subjekteve të licensuara nga Komisioni i Dhënies së Licencave/Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
 4. Inspektimi konsiston në verifikimin e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik, rregullave të sigurisë gjatë prodhimit, trajnimit e punonjëse, kontrollin e kushteve të prodhimit, zbatimin e masave kundra zjarrit dhe shpëtimit në ambientet e prodhimit, trajnimit e punonjëseve për masat kundra zjarrit dhe shpëtimit.
 5. Në përfundim të inspektimit, grupi i inspektimit lëshon një akt-teknik (formati bashkëlidhur këtij urdhri), mbi gjetjet dhe rekomandimet e mëtejshme.
 6. Akti-Teknik, përpilohet nga anëtarët e grupit në 3 kopje, ku një kopje i mbetet subjektit, një kopje përcillet pranë Komisionit të Dhënies së Lejeve dhe Licencave/Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe një kopje mbahet në arkivin e Ministrisë së Mbrojtjes.
 7. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 205, datë 11.02.2019 “Për ngritjen e grupit të inspektimit të përhershëm për kontrollin e kushteve të prodhimit në ambientet e subjekteve të licensuara për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil prodhimin e artikujve piroteknike dhe fishekzjarre për përdorim civil dhe prodhimin çaktivizimin dhe riparimin e armëve”, shfuqizohet.
 8. Ndjek zbatimin e këtij urdhri Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, dhe Kryetari i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. Prot

Datë / / 2019

AKT-TEKNIK

Mbështetur dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 7 dhe pika 2 e nenit 7/1 të ligjit 9126 datë 29.07.2003 “Për përdorimin Civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 13 të ligjit 74/2014 “Për Armët”, Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nrdatë.....”Për ngritjen e grupit të inspektimit të përhershëm për kontrollin e kushteve të prodhimit në ambientet e subjekteve të licensuara për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil prodhimin e artikujve piroteknike dhe fishekzjarre për përdorim civil dhe prodhimin çaktivizimin dhe riparimin e armëve” si dhe Licensës nr..... datë të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, grupi i inspektimit me përbërjen sa më poshtë:

1.
- 2.....
- 3.....

Kontrolloi Subjektin,
me adresë.....,
me Administrator.....

Nga Kontrolli rezultoi se:

1. _____

2. Rekomandime

3. Masa të mëteshje

- Pezullim aktiviteti deri më marrjen e masave korrektuese*
- Vazhdimin e aktivitetit deri më marrjen e masave korrektuese*

Mbështetur sa më sipër, lëshojmë këtë akt teknik

I vlefshëm deri në (6 muaj)

Nënshkrimi i Përfaqësuesit të Subjektit

Nënshkrimi i grupit të inspektimit